



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË

DEGA VENDORE TIRANË

**NOTER EDLIRA O. MALAJ
(GALANXHI)
ADRESA RR.SAMI FRASHERI,
PALLATI BLU PERBALLE
GJIMNAZIT PETRO NINI
LUARASI ,KATI 2
TEL: 694439947**

KRIJIMI I SHOQATAVE OSE AKTI I THEMELIMIT

Nr. repertori: 1817

Nr. koleksioni: 843

Tirane më 02/09/2025

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 124/2024, datë 19/12/2024 "Për mbrojtjen e të dhënave personale"
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar

**Akti noterial përbëhet nga 3 fletë*



A2025053010079140138



A2025053010079140138

AKTI THEMELIMI

Sot, para meje Notëre EDLIRA O. MALAJ (GALANXHI), anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tiranë, RR.SAMI FRASHERI, PALLATI BLU PERBALLE GJIMNAZIT PETRO NINI LUARASI, KATI 2, u paraqit personalisht:

THEMELUES:

Jetmir Rexhepi, atësia Ali, amësia Shefkije, shtetas Shqiptar, lindur në Prishtinë, Kosova (XKS) dhe banues në TIRANË, me adresë Ndrekë Luca; Nd. 8; H. 3; Ap. 28; Njësia Administrative Nr. 5; Njësia Bashkiake Nr. 5; 1019; Tiranë, lindur më 20/01/1988, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 038951956 dhe nr. personal I80120054C.

ORTAK:

Liman Buzoku, atësia Fetah, amësia Zejnije, shtetas Kosovar, lindur në PRISHTINE dhe banues në Kosovë, me adresë Kosovë, lindur më 08/08/1984, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. personal 1500239405.

Jetmir Rexhepi ka vendosur të themelojë shoqërinë tregtare "SOL AURA" shpk, me kushtet si më poshtë:

NENI 1**STATUSI JURIDIK**

Shoqëria Tregtare "SOL AURA" Sh.p.k është formuar si Shoqëri tregtare sipas ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, (në vazhdim referuar si "Shoqëria").

Shoqëria është Person Juridik Privat Shqiptar.

Ajo ka formën e një Shoqërie me Përgjegjësi të Kufizuar.

NENI 2**EMRI I SHOQËRISË**

Shoqëria do të dalë në qarkullimin juridiko - civil me emrin "SOL AURA" Sh.p.k.

NENI 3**OBJEKTI I VEPRIMTARISË**

Objekti i Veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë:

- Nxjerrie,perpunim, prerje, tregetim me shumice e pakice, import-export, e te gjithë llojeve te produkteve , deri ne pergatitien dhe ofrimin e produktit te gatshem.
- Shitje, punime, tregetim me shumice dhe pakice, import-eksport i te gjithë llojeve te mineraleve - dhe te nenprodukteve te tyre dhe produkteve te ndryshme.
- Financim, pergatitje, zbatim dhe konsulence ne fushen inxhinierike, elektrike, panele solare, fotovoltaike dhe te ndertimit.
- Tregetim me shumice dhe pakice, per import dhe eksport i mallrave te ndryshem industrial, transport dhe sherbim online ne menyre elektronike.
- Financime ne fusha te ndryshme.

• Aktivitete tregtare dhe shërbime të ndryshme në fushën e turizmit, hotelevisë, restoranteve, bar-kafeve dhe shërbimeve të ngjashme.

• Investime në pasuri të paluajtshme, blerje, shitje, qira, menaxhim dhe zhvillim projektsh ndërtimore dhe infrastrukturore.

• Prodhim dhe tregtim ushqimesh dhe pijeve, përfshirë produkte bujqësore, blegtorale dhe të përpunuara.

• Shërbime IT dhe teknologjike, përfshirë zhvillim softuerësh, platforma online, tregti elektronike, marketing digjital, etj.

• Transport dhe logjistikë, përfshirë transport mallrash dhe udhëtarësh, shërbime magazinimi dhe shpërndarjeje.



A2025053010079140138

- Shërbime konsulence dhe ndërmjetësimi, juridike, financiare, ekonomike dhe administrative.
- Energjia e rinovueshme, përfshirë investime dhe menaxhim në fushën e energjisë diellore, eolike dhe burimeve të tjera të qëndrueshme.
- Import-eksport i pajisjeve mjekësore dhe farmaceutike, si dhe ofrimi i shërbimeve të lidhura.
- “Shoqëria mund të ushtrojë edhe çdo aktivitet tjetër tregtar apo shërbim të lejuar nga legjislacioni shqiptar në fuqi”. Kjo e bën objektin gjithëpërfshirës dhe i hap rrugë çdo fushe të re pa qenë nevoja të ndryshosh aktet e shoqërisë.

NENI 4

SELIA E SHOQËRISË

Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: “Apartament, më nr. pasurie 358/7+1-4, vol 13, faqe 18, zk. 2291, ndodhur ne Kavaje, Kryemedhenj, Durrës, Shqipëri”.

NENI 5

KAPITALI I SHOQËRISË

Kapitali i shoqërisë është në vlerën 100 000 (njëqind mijë) leke, i ndarë në 2 (dy) kuota me vlerë nominale të një kuote prej 50 000 (pesedhjetë mijë) lekë dhe 50 000 (pesedhjetë mijë) lekë.

Z. **Jetmir Rexhepi** zotëron 1 (një) kuotë të kapitalit themeltar, me vlere 50 000 (pesedhjetë mijë) lekë pra 50 % të tij dhe Liman Buzoku zotëron 1 (një) kuotë të kapitalit themeltar, me vlere 50 000 (pesedhjetë mijë) lekë pra 50% të tij.

Kapitali themeltar është investuar nga ortaku themelues Z. Jetmir Rexhepi dhe ortaku z.Liman Buzoku.

NENI 6

KOHËZGJATJA E SHOQËRISË

Afati kohor i zhvillimit të aktivitetit është i pakufizuar dhe fillon me regjistrimin e Shoqërisë në Regjistrin e Biznesit. Ortakët e Shoqërisë mund të vendosin kufizimin e afatit të veprimtarisë dhe më pas zgjatjen e saj një apo disa herë, sipas një vendimi të posaçëm.

NENI 7

ORGANET DREJTUESE

Bazuar në dispozitat e ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve — organi më i lartë vendimarrës;
2. Administratorët — organi ekzekutiv dhe administrativ i Shoqërisë.

Mënyra e organizimit dhe funksionimit të tyre është e përcaktuar në Statutin e Shoqërisë.

Shoqëria do të administrohet nga Administratorët të cilët mund të zgjidhen për një afat deri në pesë vjet me të drejtë rizgjedhjeje.

Administratori i Shoqërisë “SOL AURA” Sh.p.k, është Z. **Jetmir Rexhepi**, i cili zgjidhet për një periudhë 5 vjetecare me të drejtë ripërtëritje.

Shoqëria do të përfaqësohet përpara çdo organi administrativ, gjyqësor, apo çdo entiteti tjetër publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga Administratori i shoqërisë, i cili i ushtron të drejtat e tij në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe me legjislacionin shqiptar në fuqi.

NENI 8

LIGJI I APLIKUESHËM

Veprimtaria e Shoqërisë rregullohet nga rregullat e Statutit të firmosur nga Ortakët Themelues sipas parashikimeve të ligjit në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

NENI 9

ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Mosmarrëveshjet që mund të lindin midis ortakëve apo midis ortakëve dhe Shoqërisë dhe që mund të kenë si objekt të drejta si rrjedhim i raporteve të tyre me Shoqërinë, do të zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor perkates.

NENI 10

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Akt Themelimi përpilohet në 4 (kater) kopje në gjuhën shqip, dhe nënshkruhet nga ortaku i vetëm themelues. Unë Noterja verifikova identitetin e palëve nëpërmjet dokumenteve të identitetit dhe pasi e gjeta përmbajtjen e



A2025053010079140138

aktit noterial të mësipërm, në përputhje të plotë me nenin 62, 63 e vijues të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", vërtetoj nënshkrimin e tyre. Në zbatim të ligjit 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", unë Noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të kësaj kontrate, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

THEMELUESI

Jetmir Rexhepi

ORTAK:

Liman Buzoku

Liman Buzoku

Bj.

NOTER
EDLIRA O. MALAJ(GALANXHI)

[Signature]